



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR



PROCESVERBAL

**MBLEDHJEN E PARË E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË
APLIKIMEVE (KVA) PËR GBP**

6 tetor 2025

Hapja e mbledhjes

Z.Stiljan Llavdaniti, Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, hapi mbledhjen e pare të Komisionit të Vlerësimit të aplikimeve për GBP, duke falenderuar pjesëmarrësit dhe prezantuar përbërjen e Komisionit. Ai prezantoi tre anëtarët e përhershëm të komisionit: z. Sonil Frashëri, z. Fran Brahimi dhe znj. Adelina Farriçi. Sipas kalenderit ditën e sotme u prezantuan për tu vlerësuar paraprakisht **Treguesit Financiar dhe Treguesi i SMP**. Për çdo plan vendor janë përcaktuar përfaqësues nga ministritë përkatëse, konkretisht: për **Planin e Mbarështimit të Pyjeve** – përfaqësues nga **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**; për **Planin e Menaxhimit të Mbetjeve** – po ashtu nga **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**; për **Planin Vendor Social dhe Planin e Barazisë Gjinore** – përfaqësues nga **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**; për **Planin e Arsimit Parauniversitar** – përfaqësues nga **Ministria e Arsimit dhe Sportit**; ndërsa për **Planin e Integritetit** – përfaqësues nga **Ministri Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin**. Për **treguesit financiarë** – përfaqësues nga **Ministria e Financave dhe Treguesit e SMP** – përfaqësues nga **Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore**.

Në vijim të sesionit, z.Stiljan Llavdaniti, iu drejtua KVA-së duke kërkuar dakordësinë e tyre për të vijuar me procesin e paraqitjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga bashkitë. Të gjithë anëtarët dhe pjesëmarrësit u shprehën dakord për vijimin e procesit sipas rendit të përcaktuar.

Z.Llavdaniti vijoi me një shpjegim të procedurës së vlerësimit të aplikimeve referuar Kreut IV, pika 4 e Udhëzimit të Përbashkët për GBP dhe hapat konkret, duke theksuar se ajo ndahet në dy faza kryesore.

Znj.Matilda Shabani shtroi pyetje në lidhje me periudhën e vlerësimit të aplikimeve, referuar periudhës shtator 2025, të përmendur në dokument dhe u sqarua se ka të bëjë me vlerësimin paraprak të dokumentacionit. Gjithashtu, në vijim të diskutimeve *z.Fran Brahimi* shpjegoi konceptin e **Përfshirjes në Buxhetin Vendor** si nën pikë referuar Aneksit 1 të Udhëzimit. Më tej *znj.Adelina Farrici* shtroi pyetjen lidhur me **Monitorim dhe Raportim** (përsëri nën pikë në referencë të Aneksit 1 të Udhëzimit). *Z.Llavdaniti* shpjegoi procesin mbi kërkesën e mundshme nga donatorët për të monitoruar procesin sikurse parashikohet në udhëzim.

Me përfundimin e komenteve, *z.Stiljan Llavdaniti* deklaroi sesionin e parë të mbledhjes të mbyllur.

Sesioni i dytë:

Anëtarët e Komisionit vijuan me nënshkrimin e **Deklaratës së Konfidencialitetit dhe Konfliktit të Interesit**, në përputhje me kërkesat e **Udhëzimit të Përbashkët**. Me përfundimin e këtij veprimi, u **konstitua zyrtarisht Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve (KVA)** dhe **nisën procedurat për shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga bashkitë**.

Në vijim, nisi **pjesa e dytë e mbledhjes**, që i kushtohej **vlerësimit paraprak të treguesve financiarë**.

Znj.Olta Caca prezantoi rezultatet paraprake, ndërkohë që *z.Stiljan Lavdaniti* ritheksoi se **të gjitha informacionet përkatëse janë të pasqyruara në memorandumin shoqërues**.

Znj.Caca sqaroi se, sipas udhëzimit, **AMVV do të publikojë rezultatet paraprake**, dhe në mungesë të ankesave nga bashkitë, **ato do të konsiderohen përfundimtare**. Ajo theksoi se të dhënat janë **të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisw**, duke ndarë analizën përpara KVA-së.

- **Për treguesin e detyrimeve të prapambetura**, rezultoi se **8 bashki** kanë raportuar një nivel detyrimesh **jo më shumë se 30%**, ndërsa **vlera e përgjithshme e këtij treguesi është 754,098 mijë lekë**.
- **Sa i përket realizimit të planit të buxhetit**, u evidentua se **35 bashki** kanë arritur **realizimin faktik të planifikuar** sipas parashikimeve buxhetore.
- **Në lidhje me të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme**, u konstatua se **vetëm 7 bashki** kanë arritur një **nivel realizimi prej të paktën 20%**.

Znj.Farriçi dhe *Z.Brahimi* patën diskutime në lidhje me treguesin për detyrimet të prapambetura nga bashkitë. Në vijim të diskutimit nga parafolësit *znj.Caca* dhe *znj.Valbona Karakaçi* shprehën opinionin mbi çështjen e ngritur duke theksuar se qëllimi i GBP është incentivimi i bashkive dhe nxitja e tyre për tu përmirësuar.

Z.Stiljan Lavdaniti theksoi se udhëzimi aktual është miratuar në përputhje me procedurat zyrtare, pas një procesi të gjerë konsultimi, ku të gjithë kanë pasur mundësinë të shprehin opinionet dhe sugjerimet e tyre. Ai shtoi se procesi ka qenë burokratik dhe me karakter vendimmarrës, ku eksperiencia për vitin 2025 do të shërbejë si përvojë e vlefshme për përmirësimin e mëtejshëm të udhëzimit dhe procedurave për vitin e ardhshëm, nëse vlerësohet e arsyeshme.

Pas përfundimit të prezantimit lidhur me Treguesit Financiar, Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve kanë shprehur mbi dakordësinë dhe/ose mos-dakordësinë e tyre si në vijim:

Aneksi 1: Vlerësimi paraprak treguesve Financiar dhe përqindja e tyre

Dokumentacioni bazuar në SIFQ për Treguesit Financiar				
Nr.	Bashkia	Kriteret e cilësisë		
		Niveli i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura me të paktën 30%, në periudhën referuese nga 31.12.2024 deri 30.06.2025	Rezultatet Paraprake të Bashkive fituese	Vlerësimi (Pesha e treguesit të GBP 10%)
1	Belsh	7%	Jo	0%
2	Berat	-17%	Jo	0%

3	Bulgizë	0%	Jo	0%
4	Cërrik	-12%	Jo	0%
5	Delvinë	9%	Jo	0%
6	Devoll	93%	Jo	0%
7	Dibër	-9%	Jo	0%
8	Dimal	21%	Jo	0%
9	Divjakë	16%	Jo	0%
10	Dropull	0%	Jo	0%
11	Durrës	-3%	Jo	0%
12	Elbasan	11%	Jo	0%
13	Fier	5%	Jo	0%
14	Finiq	-21%	Jo	0%
15	Fushë-Arrës	0%	Jo	0%
16	Gjirokastër	0%	Jo	0%
17	Gramsh	-16%	Jo	0%
18	Has	0%	Jo	0%
19	Himarë	-32%	Po	10%
20	Kamëz	0%	Jo	0%
21	Kavajë	-2%	Jo	0%
22	Këlcyrë	0%	Jo	0%
23	Klos	-4%	Jo	0%
24	Kolonjë	-57%	Po	10%
25	Konispol	-43%	Po	10%
26	Korçë	40%	Jo	0%
27	Krujë	0%	Jo	0%
28	Kuçovë	2449%	Jo	0%
29	Kukës	-35%	Po	10%
30	Kurbín	0%	Jo	0%
31	Lezhë	53%	Jo	0%
32	Libohovë	-13%	Jo	0%
33	Librazhd	703%	Jo	0%
34	Lushnjë	37%	Jo	0%
35	Malësi e Madhe	-100%	Po	10%
36	Maliq	216%	Jo	0%
37	Mallakastër	0%	Jo	0%
38	Mat	-47%	Po	10%
39	Memaliaj	-22%	Jo	0%
40	Mirditë	0%	Jo	0%
41	Patos	-100%	Po	10%

42	Peqin	4%	Jo	0%
43	Përmet	0%	Jo	0%
44	Pogradec	11%	Jo	0%
45	Poliçan	-3%	Jo	0%
46	Prrenjas	0%	Jo	0%
47	Pukë	-54%	Po	10%
48	Pustec	0%	Jo	0%
49	Roskovec	-6%	Jo	0%
50	Rrogozhinë	0%	Jo	0%
51	Sarandë	684%	Jo	0%
52	Selenicë	162%	Jo	0%
53	Shijak	0%	Jo	0%
54	Shkodër	0%	Jo	0%
55	Skrapar	-4%	Jo	0%
56	Tepelenë	-21%	Jo	0%
57	Tiranë	49%	Jo	0%
58	Tropojë	1%	Jo	0%
59	Vau-Dejës	212%	Jo	0%
60	Vlorë	-17%	Jo	0%
61	Vorë	0%	Jo	0%

Dokumentacioni bazuar në SIFQ për Treguesit Financiar				
Nr.	Bashkia	Kriteret e cilësisë		
		Realizimi i Planit të Buxhetit të Bashkisë, realizimi faktik të buxhetit në 6 mujorin e parë të vitit 2025 ndaj planit vjetor për vitin 2025 jo më pak se 35%	Rezultatet Paraprake të Bashkive fituese	Vlerësimi (Pesha e treguesit të GBP 10%)
1	Belsh	36%	Po	10%
2	Berat	40%	Po	10%
3	Bulqizë	41%	Po	10%
4	Cërrik	46%	Po	10%
5	Delvinë	35%	Po	10%
6	Devoll	36%	Po	10%
7	Dibër	40%	Po	10%

8	Dimal	37%	Po	10%
9	Divjakë	40%	Po	10%
10	Dropull	34%	Jo	0%
11	Durrës	33%	Jo	0%
12	Elbasan	31%	Jo	0%
13	Fier	32%	Jo	0%
14	Finiq	52%	Po	10%
15	Fushë-Arrës	33%	Jo	0%
16	Gjirokastrë	32%	Jo	0%
17	Gramsh	39%	Po	10%
18	Has	52%	Po	10%
19	Himarë	9%	Jo	0%
20	Kamëz	31%	Jo	0%
21	Kavajë	30%	Jo	0%
22	Këlcyrë	41%	Po	10%
23	Klos	38%	Po	10%
24	Kolonjë	41%	Po	10%
25	Konispol	45%	Po	10%
26	Korçë	34%	Jo	0%
27	Krujë	21%	Jo	0%
28	Kuçovë	40%	Po	10%
29	Kukës	41%	Po	10%
30	Kurbin	40%	Po	10%
31	Lezhë	22%	Jo	0%
32	Libohovë	30%	Jo	0%
33	Librazhd	41%	Po	10%
34	Lushnje	32%	Jo	0%
35	Malësi e Madhe	40%	Po	10%
36	Maliq	37%	Po	10%
37	Mallakastër	23%	Jo	0%
38	Mat	42%	Po	10%
39	Memaliaj	39%	Po	10%
40	Mirditë	40%	Po	10%
41	Patos	28%	Jo	0%
42	Peqin	35%	Po	10%
43	Përmet	30%	Jo	0%
44	Pogradec	34%	Jo	0%
45	Polëçan	54%	Po	10%
46	Prrenjas	29%	Jo	0%

47	Pukë	43%	Po	10%
48	Pustec	29%	Jo	0%
49	Roskovec	37%	Po	10%
50	Rrogozhinë	49%	Po	10%
51	Sarandë	28%	Jo	0%
52	Selenicë	26%	Jo	0%
53	Shijak	38%	Po	10%
54	Shkodër	26%	Jo	0%
55	Skrapar	37%	Po	10%
56	Tepelenë	51%	Po	10%
57	Tiranë	22%	Jo	0%
58	Tropojë	36%	Po	10%
59	Vau Dejës	17%	Jo	0%
60	Vlorë	22%	Jo	0%
61	Vorë	41%	Po	10%

Dokumentacioni bazuar në SIFQ për Treguesit Financiar				
Nr.	Bashkia	Kriteret e cilësisë		
		Niveli i realizimit të të ardhurave nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme më shumë se 20%, kundrejt vitit parardhës	Rezultatet Paraprake të Bashkive fituese	Vlerësimi (Pesha e treguesit të GBP 10%)
1	Belsh	14%	Jo	0%
2	Berat	-4%	Jo	0%
3	Bulqizë	57%	Po	10%
4	Cërrik	26%	Po	10%
5	Delvinë	-11%	Jo	0%
6	Devoll	-3%	Jo	0%
7	Dibër	43%	Po	10%
8	Divjakë	2%	Jo	0%
9	Dropull	5%	Jo	0%
10	Durrës	7%	Jo	0%
11	Elbasan	-22%	Jo	0%
12	Fier	28%	Po	10%

13	Finiq	7%	Jo	0%
14	Fushë-Arrës	44%	Po	10%
15	Gjirokastrë	6%	Jo	0%
16	Gramsh	-25%	Jo	0%
17	Has	-1%	Jo	0%
18	Himarë	-10%	Jo	0%
19	Kamëz	5%	Jo	0%
20	Kavajë	7%	Jo	0%
21	Këlcyrë	-56%	Jo	0%
22	Klos	-17%	Jo	0%
23	Kolonjë	-8%	Jo	0%
24	Konispol	-9%	Jo	0%
25	Korçë	8%	Jo	0%
26	Krujë	-48%	Jo	0%
27	Kuçovë	7%	Jo	0%
28	Kukës	7%	Jo	0%
29	Kurbin	-13%	Jo	0%
30	Lezhë	-5%	Jo	0%
31	Libohovë	-42%	Jo	0%
32	Librazhd	12%	Jo	0%
33	Lushnje	-23%	Jo	0%
34	Malësi e Madhe	10%	Jo	0%
35	Maliq	-26%	Jo	0%
36	Mallakastër	-32%	Jo	0%
37	Mat	-18%	Jo	0%
38	Memaliaj	-30%	Jo	0%
39	Mirditë	-10%	Jo	0%
40	Patos	-7%	Jo	0%
41	Peqin	-9%	Jo	0%
42	Përmet	65%	Po	10%
43	Pogradec	0%	Jo	0%
44	Poliçan	5%	Jo	0%
45	Prrenjas	-25%	Jo	0%
46	Pukë	-22%	Jo	0%
47	Pustec	-35%	Jo	0%
48	Rogozhinë	3%	Jo	0%
49	Roskovec	1%	Jo	0%
50	Sarandë	15%	Jo	0%
51	Selenicë	-42%	Jo	0%

52	Shijak	17%	Jo	0%
53	Shkodër	21%	Po	10%
54	Skrapar	-10%	Jo	0%
55	Tepelenë	-28%	Jo	0%
56	Tiranë	4%	Jo	0%
57	Tropojë	13%	Jo	0%
58	Dimal	-5%	Jo	0%
59	Vau-Dejë	0%	Jo	0%
60	Vlorë	8%	Jo	0%
61	Vorë	-19%	Jo	0%

Z.Llavdaniti i jep fjalën znj.Erlisa Labi për të vijuar me prezantimin e Treguesit për Sistemin e Matjes së Performancës. Nga rezultatet paraprake për tre kriteret dhe verifikimet e kryera rezulton se 61 bashkitë e vendit kanë raportuar të dhëna të plota brenda afatit të përcaktuar dhe gjithashtu **të gjitha bashkitë kanë qenë të përfaqësuara me të paktën një anëtar të stafit në trajnimet e zhvilluara nga AMVV.Megjithatë, vetëm 29 bashki kanë pasur përputhje të plotë (100%) ndërmjet stafit pjesëmarrës në trajnim dhe stafit të përcaktuar zyrtarisht për zbatimin e sistemit të matjes së performancës.**

Këto bashki janë: Berat, Bulqizë, Dibër, Mat, Durrës, Krujë, Shijak, Elbasan, Librazhd, Prrenjas, Gjirokastrë, Tepelenë, Devoll, Korçë, Maliq, Tropojë, Mirditë, Malësi e Madhe, Kamëz, Kavajë, Rrogozhinë, Tiranë, Vorë, Finiq, Himarë, Konispol, Sarandë, Vlorë dhe Selenicë.

Pas përfundimit të prezantimit lidhur me Treguesit Financiar, Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve kanë shprehur mbi dakortësinë dhe/ose mos-dakortësinë e tyre si në vijim:

Aneksi 2: Vlerësimi paraprak i treguesit të Sistemit të Matjes së Performancës dhe përqindja e tyre

Dokumentacioni i dorëzuar nga bashkitë për SMP					
Nr.	Bashkia	Kriteret e cilësisë			
		Të dhënat e raportuara janë brenda afatit të përcaktuar (pesha e treguesit 2%)	Të dhënat e raportuara për të gjithë treguesit (pesha e treguesit 2%)	Stafi i NJP-së i Bashkisë ka ndjekur trajnimet (pesha e treguesit 1%)	Vlerësimi (pesha e treguesit gjithsej të GBP 5%)
1	Belsh	Po	Po	Jo	4%
2	Berat	Po	Po	Po	5%
3	Bulqizë	Po	Po	Po	5%
4	Cërrik	Po	Po	Jo	4%

5	Delvinë	Po	Po	Jo	4%
6	Devoll	Po	Po	Po	5%
7	Dibër	Po	Po	Po	5%
8	Dimal	Po	Po	Jo	4%
9	Divjakë	Po	Po	Jo	4%
10	Dropull	Po	Po	Jo	4%
11	Durrës	Po	Po	Po	5%
12	Elbasan	Po	Po	Po	5%
13	Fier	Po	Po	Jo	4%
14	Finiq	Po	Po	Po	5%
15	Fushë-Arrës	Po	Po	Jo	4%
16	Gjirokastrë	Po	Po	Po	5%
17	Gramsh	Po	Po	Jo	4%
18	Has	Po	Po	Jo	4%
19	Himarë	Po	Po	Po	5%
20	Kamëz	Po	Po	Po	5%
21	Kavajë	Po	Po	Po	5%
22	Këlcyrë	Po	Po	Jo	4%
23	Klos	Po	Po	Jo	4%
24	Kolonjë	Po	Po	Jo	4%
25	Konispol	Po	Po	Po	5%
26	Korçë	Po	Po	Po	5%
27	Krujë	Po	Po	Po	5%
28	Kuçovë	Po	Po	Jo	4%
29	Kukës	Po	Po	Jo	4%
30	Kurbin	Po	Po	Jo	4%
31	Lezhë	Po	Po	Jo	4%
32	Libohovë	Po	Po	Jo	4%
33	Librazhd	Po	Po	Po	5%
34	Lushnje	Po	Po	Jo	4%
35	Malësi e Madhe	Po	Po	Po	5%
36	Maliq	Po	Po	Po	5%
37	Mallakastër	Po	Po	Jo	4%
38	Mat	Po	Po	Po	5%
39	Memaliaj	Po	Po	Jo	4%
40	Mirëditë	Po	Po	Po	5%
41	Patos	Po	Po	Jo	4%
42	Peqin	Po	Po	Jo	4%
43	Përmet	Po	Po	Jo	4%

44	Pogradec	Po	Po	Jo	4%
45	Poliçan	Po	Po	Jo	4%
46	Prrenjas	Po	Po	Po	5%
47	Pukë	Po	Po	Jo	4%
48	Pustec	Po	Po	Jo	4%
49	Roskovec	Po	Po	Jo	4%
50	Rrogozhinë	Po	Po	Po	5%
51	Sarandë	Po	Po	Po	5%
52	Selenicë	Po	Po	Po	5%
53	Shijak	Po	Po	Po	5%
54	Shkodër	Po	Po	Jo	4%
55	Skrapar	Po	Po	Jo	4%
56	Tepelenë	Po	Po	Po	5%
57	Tiranë	Po	Po	Po	5%
58	Tropojë	Po	Po	Po	5%
59	Vau-Dejës	Po	Po	Jo	4%
60	Vlorë	Po	Po	Po	5%
61	Vorë	Po	Po	Po	5%

Mbyllja e Mbledhjes

Në përfundim të mbledhjes, z.*Stiljan Lavdaniti* bëri mbylljen e takimit, duke theksuar për mbledhjen e ardhshme se procesi i vlerësimit të planeve ka qenë kompleks dhe voluminoz. Ai nënvizoi se në takimin e radhës do të bëhet një shpjegim më i detajuar i procesit të vlerësimit që në fillim, me qëllim rritjen e qartësisë dhe efikasitetit në vijimin e punës së komisionit.